UDHËZIM
Nr. 2, datë 15.4.2016

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 17, DATË 17.10.2012, "PËR PROCEDURAT E SHITJES SË BANESAVE, PJESË PËRBËRËSE E OBJEKTEVE NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, PËR ENTIN KOMBËTAR TË BANESAVE, PËR QËLLIM PRIVATIZIMI

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, "Për programet sociale të strehimit", të ndryshuar, të vendimeve të Këshillit të Ministrave për kalim objektesh në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit për Entin Kombëtar të Banesave, më qëllim privatizimi,

UDHËZON:

Në udhëzimin e MPPT-së nr. 17, datë 17.10.2012, "Për procedurat e shitjes së bane-save, pjesë përbërëse e objekteve në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për Entin Kombëtar të Banesave, për qëllim privatizimi", i ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 2, pika 2.1, rreshti i tretë pas fjalëve "akteve respektive", bëhet ndryshimi me këtë përmbajtje: "dhe pasi të jetë lëshuar nga zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, certifikata e pronësisë në emër të EKB-së".

2. Në pikën 2, pas pikës 2.2 shtohet pika 2.3 me këtë përmbajtje:

2.3 Brenda 15 ditësh nga data e lëshimit të certifikatës së pronësisë nga ana e ZVRPP-së, në emër të EKB-së, kjo e fundit të ketë kryer njoftimin e të gjithë qytetarëve përfitues, sipas listës bashkëngjitur VKM-së përkatëse, në lidhje me afatet në dispozicion, procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm, duke marrë kundërfirmën e qytetarëve për të faktuar njoftimin e kryer".

3. Në pikën 4, "Vlera totale e privatizimit të banesës", pika 4.1 në fund të paragrafit: "K-është kostoja lekë/m^2 për sipërfaqen e ndërtimit të objektit, referuar vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 310, datë 21.4.2011, "Për përcak-timin e kostos mesatare lekë/m^2, për projekte shtetërore të transformuara në fond banesash, kaluar në përgjegjësi administrimi të Entit Kombëtar të Banesave, me qëllim privatizimi për banorët posedues, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave, të periudhës 2009–2011", shtohet fjala "i ndryshuar".

4. Në pikën 5, "Lidhja e kontratës, mënyra e likuidimit të banesës dhe përmbajtja e dosjes", bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- Pika 5.1, germat "a" dhe "b" shfuqizohen dhe riformulohen si më poshtë vijon:

a) Çdo qytetar, sipas pikës 2 të këtij udhëzimi, detyrohet të lidhë kontratën e privatizimit me Entin Kombëtar të Banesave brenda 2 (dy) vjetësh nga momenti i lëshimit të certifikatës së pronësisë nga ZVRPP-ja, në emër të Entit Kombëtar të Banesave.

Për objekte certifikata e pronësisë të cilëve ka dalë para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, si afat fillestar i numërimit të periudhës 2-vjeçare, të merret data e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.

- Në pikën 5.1, germa "c" bëhet "germa "b".

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ZHVILLIMIT URBAN
Eglantina Gjermeni